



Universiteti i Prishtinës
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE NË PRISHTINË
Departamenti: Gjeografi

Lënda: Planifikim hapësinor



Ferim Gashi,
2026, PRISHTINË

Të dhëna bazike të lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	F.SH.M.N, Departamenti i Gjeografisë, Prishtinë
Titulli i lëndës:	Planifikim hapësinor
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III, semestri VI-të
Numri i orëve në javë:	3 (L) + 2 (U)
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	L: E martë: 15:45-18:00, Salla nr. 1 U: E martë: 13:30-15:00, Lab.
Mësimdhënësi i lëndës:	Ferim Gashi (L), Ferat Krasniqi (U)
Termini i konsultimeve	E enjte :10:00-12:00
Detajet kontaktuese:	ferim.gashi@uni-pr.edu ; ferat.krasniqi@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës:



Planifikimi hapësinor është lëndë dhe aktivitet që merret me organizimin dhe rregullimin e hapësirës në një territor të caktuar, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Qëllimet kryesore të planifikimit hapësinor:

- Harmonizon veprimtaritë dhe proceset shoqërore, ekonomike dhe mjedisore.
- Siguron vendosjen dhe shpërndarjen optimale të popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike.
- Mundëson përdorim racional dhe të qëndrueshëm të tokës dhe burimeve natyrore.
- Mbron mjedisin dhe ruan vlerat kulturore, historike dhe estetike të hapësirës.

Qëllimet e kursit (modulit)



- I. Të njohë studentët me procesin e planifikimit të hapësirës si rezultat i zhvillimeve bashkëkohore.
- II. Të mundësojë përvetësimin e faktorëve natyrorë, demografikë dhe shoqërorë që ndikojnë në planifikimin hapësinor.
- III. Të ofrojë njohuri mbi proceset infrastrukturore dhe rëndësinë e tyre në planifikimin hapësinor

Rezultatet e pritura të nxënies



Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje që:

- Të kuptojë rëndësinë e planifikimit të hapësirës si kërkesë e domosdoshme për cilësi dhe jetë më të mirë.
- Të njohë dhe të përvetësojë modele dhe praktika planifikimi nga vendet e zhvilluara, të aplikueshme në hapësira të ndryshme.
- Të identifikojë dukuritë dhe proceset shoqërore e ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e vendbanimeve dhe rrethinës.
- Të zbatojë njohuritë e fituara në proceset e planifikimit hapësinor, duke vlerësuar ndikimin e vendosjes së aktiviteteve dhe infrastrukturës në zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve.

Metodologjia e mësimdhënies:



- Ligjerata në formë dialogu, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutime, debate.
- Për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive të plota dhe të qëndrueshme do të përzgjedhen metoda e strategji të përshtashme të mësimdhënies që motivojnë dhe nxisin të nxënit aktiv.
- Në përgjithësi, prezantimet do të jenë në Power Point .

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:



Nota përfundimtare do të nxirret nga këto elemente:

- Vlerësimi i parë:20%
- Vlerësimi i dytë:20%
- Detyrat e shtëpisë / angazhime të tjera:..... 20%
- Vijimi i rregullt i mësimi:15%
- Provimi final: 25%
- **Totali:****100%**

- Dorëzimi i punimit seminarik: deri më **25.05.2026**, ora **23:59**
- Dorëzimi i detyrës/seminarit duhet të bëhet në formatet e mëposhtme:
 - PDF, Word dhe format GIS - në formatin **Shapefile (.shp)**,
 - përmes e-mailit në adresën: ferim.gashi@uni-pr.edu
- Data e prezantimit: **26.05.2026**.

Vërejtje: Studentët duhet të ndjekin të paktën 50% të ligjëratave dhe ushtrimeve, në mënyrë që të kenë të drejtë të marrin vlerësimin final. Në të kundërtën, janë të detyruar ta përsërisin lëndën në vitin e ardhshëm akademik.

SISTEMI I VLERËSIMIT



Nota	ECTS nota	Suksesi në %	Përkufizimi
10	A	95-100%	SHKËLQYESHËM – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
9	B	85-94%	SHUMË MIRË – arritje mbi mesatare, por me disa gabime
8	C	75-84%	MIRË – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
7	D	65-74%	KËNAQSHËM - mirë, por me mjaftë gabime
6	E	51-64%	MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale
5	FX	40-50%	DOBËT - kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kredit
5	F	00-39%	DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredit.

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Lënda e studimit të planifikimit hapësinor, konceptet
<i>Java e dytë:</i>	Kriteret shkencore në procesin e planifikimit
<i>Java e tretë:</i>	Fazat kryesore në procesin e planifikimit hapësinor
<i>Java e katërt:</i>	Aspektet legjislative në procesin e planifikimit hapësinor
<i>Java e pestë:</i>	Planet hapësinore, përmbajtja dhe detyrat e planeve hapësinore
<i>Java e gjashtë:</i>	Llojet dhe natyra e planeve hapësinore, Plani urbanistik, komunal, regjional dhe nacional
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësim intermediary
<i>Java e tetë:</i>	Organizimi dhe mënyra e hartimit të planit
<i>Java e nëntë:</i>	Puna ekipore e planeve hapësinore
<i>Java e dhjetë:</i>	Faktorët zhvillimor të planifikimit hapësinor
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Elementet e identitetit të mjedisit natyror dhe kulturor
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Pasuria shoqërore si lëndë e planifikimit hapësinor
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Infrastruktura dhe vendbanimet në planifikimin hapësinor
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Analiza e planeve komunale (shembull) dhe planit hapësinor të Kosovës
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësim intermediary

Literatura:



1. Ibrahim Ramadani, Planifikimi hapësinor dhe urban, Prishtinë, 2013.
2. American Planning Association: **Planning and Urban Design Standards**, New York, 2006.
3. REIMER, M, P GETIMIS and H BLOTEVOGEL. Spatial Planning Systems and Practices in Europe: A Comparative Perspective on Continuity and Changes. Hoboken: Taylor and Francis, 2014.
4. Material i shtypur i kursit; artikuj shkencore, raporte relevante, etj., studenteve ju dorezohet parapraakisht.



Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.

Obligimet e studentëve:



- ❧ Përcjellja e ligjëratave dhe ushtrimeve, realizimi i detyrave të parapara me plan-programin mësimor.
- ❧ Metoda e punës me studentët do të jetë interaktive.
- ❧ Ndershmëria akademike do të qëndrojë në marrëdhënie mësimdhënës - studentë

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj !!!



E-mail:
ferim.gashi@uni-pr.edu